



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	19.05.2023	16.06.2023	2023/0283
Eksperti Teknik	Data e autorizimit të ekspertit teknik		
Fitim Sopjani	19.05.2023		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.05.2023, OE “FLOMED SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0283, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “DOCTOR EXTERMINATOR DDD” SH.PK, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sherbime te Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit ne objektet Policore.” me nr. të prokurimit: "214-22-5200-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 379 614,27 €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues-teknik i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 28 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

Të nderuar me dt.28.04.2023 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku AK-ja ka rekomanduar për kontratë OE DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K, ndërsa neve na ka shpallur si tenderues i pasuksesshëm.

Ju sqarojmë se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Fillimisht ju sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë nga AK-ja “Doctor exterminator SHPK” ka ofertuar me çmim dukshëm më të ulët se sa çmimet e tregut në vendin tonë dhe rajon.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti ka ofertuar me preparate repeluese për gjarpinj, të cilët janë të ndaluar rreptësisht nga Organizata Shëndetësore Botërore e Kombeve të Bashkuara (OBSh) si dhe Unioni Europian (EU WHO)

Po ashtu, theksojmë që Dezinfektuesit dhe Dezinsektueset janë jo ekuivalentë me preparatet e kërkua sipas Specifikimeve teknike të Dosjes Tenderuese që i ka paraparë Shërbimi shëndetësor i Njesisë kërkuese i departamentit Epidemiologjikë të PK-së.

Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje ligjore në Pranimin e Specifikimeve të preparateve të ndaluara për përdorim. Preparati i tillë është shumë i rrezikshëm për biodiversitet të Stafit policor (10 mijë policëve dhe shërbimit të qejve-“K9”).

E theksojmë që me Ligjin e produkteve biocide (I vjetri që është i shfuqizuar më datën 10.07.2009) LIGJI NR.03/L-119 PËR PRODUKTET BIOCID DHE SHTOJCAT

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61927> (i shfuqizuar) për produkte biocide ka qenë i lejuar repelenti për gjarpinj snakes repellent që ka patur sulfur dhe naftalinë. Por me ligjin e ri që ka hyrë në fuqi gjatë kohës së Tenderit: LIGJI NR. 08/L-065 PËR PRODUKTET BIOCID DHE SHTOJCAT i botuar në “GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 25 / 19 GUSHT 2022, PRISHTINË”, NUK lejohen produkte më ndikime kancerogjene për njerëzit dhe kafshët (qentë).

Me norma ndërkombëtare Sanitare të OBSh-së (WHO-së) e (Organizatës Botërore të Shëndetësisë) për shkak të ndikimeve negative të Repelentit për gjarpinj që ka përmbytur NAFTALINË dhe SULFUR, përdorimi i tij është i ndaluar konform Ligjit mbi produkte biocide.

Në dosjen e tenderit tek Specifikimet teknike të AK-së është kërkuar: repellent për largimin e gjarpinjëve (Zvarranikëve) me përbërje SULFURI, etj.

a)Një materie aktive mjaft e rrezikshme (Materia Naftalinë) e cila është produkt që dëmton biodiversitetin tek njerëzit (janë të rrezikuar për indikacione kancerogjene reth 10 mijë (dhjetë mijë policë) për Karcinomë si dhe janë të rrezikuar Qentë e Policisë në Stacionet Policore të ashtuquajtur “ K-9” në Lebane, në Njësitë Speciale “K-9 “në Kampin Belevedere në Mitrovicë , K-9 në Kampin e Njësive Speciale në “ Vrella” si dhe në Zonat e gjelbërta të Pikave Kufitare të Republikës së Kosovës (kampet e qenve special “ K9” në Zonat ku mbahen qentë e specializuar për drogë, antiterrorizëm etj).

Ky preparat sipas departamentit të Ministrisë së ambientit dhe të Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës si dhe të WHO-së (OBSh-së) është preparat kimik KANCEROGJEN dhe se notifikimi për këtë preparat është bërë gjatë vitit 2022 nga Ministria e Ambientit (deri kur Ligji i vjetër ka qenë akoma në fuqi në Kosovë, data 19 gusht 2022. Më datën 19 gusht ka filluar zbatimi i Ligjit të ri për produkte Biocide të Notifikuara: [https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61927\(19.VIII.2022\)](https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61927(19.VIII.2022)).

4

Nga ministria ne kemi marrë 2 shkresa zyrtare që Leja notifikuese për këtë preparat jo biocid Kompania “Flomed” nuk mund të marrë ngase preparatet e tilla me sulfur dhe naftalinë nuk janë të lejuara si produkte biocide për distribuim në Republikën e Kosovës. Një Leje të tillë të cilën e ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë i lëshuar nga Ministria e Ambientit, e cila është Notifikuar si Leje distributive (biocide) më preparat të NDALUAR nga WHO-ja e të cilën leje edhe ne e kemi poseduar si kompani 4-5, më të cilën Licencë poseduese ne si kompani nuk kemi konkurruar- ofruar preparat Naftaline më Sulfur, nuk kemi patur Autorizim nga distributor i fabrikës Kollant, Italy.

Gjatë hulumtimit në platformën elektronike të Produkteve Biocide të Agjencisë për produkte kimike- biocide të Unionit Evropian në Helsinki, të Finlandës, deri më datën 17.05.2023, mbi informacionet për kemikate nuk mund të gjindet preparati në faqen **ECHA Europa eu**. Preperati Snake-A Way Snake repeling granules i cili ka qenë i regjistruar deri më datën 29.01.2018.në EPA, më numër të regjistrimit 58630-1-36488, më sasi të sulfurit të CAS numrit:7704-34-9 i koncentruar në : 15-40% dhe CAS Numër të Naftalinës :91-20-3 ,përqindja 5-10 %.

Sipas Standardeve të vitit 2012 të OSHA Hazard Communication Standard(29 CFR.1910.1200)

Sa për dijeni dhe sqarime shkencore të gjitha produktet kimike që kanë përbërje Naftaline dhe Sulfuri, Ministria e Ambientit në Prishtinë, kompanisë tone Flomed nuk i jep Leje notifikuese, që “Snakes repellent për gjarpinj më përmbajtje Naftaline dhe sulfuri ,nuk lejohet Importi sepse ky product është i ndaluar(Naftalina) dhe Sulfuri.

Mu për këtë çështje, Njësia Kërkuese e Shërbimit Shëndetësor në Policinë e Kosovës (Departamenti Epidemiologjik shëndetësor)-dhe Departamenti i Prokurimit vejnë pas një ankese të një operatori që si kriter të hiqet sulfuri dhe Naftalina dhe janë kërkuar preparate tjera për largimin e gjarpinjve : 1.Aparat “Largues gjarpinjsh më bateri” dhe 2.Aparat-Largues gjarpinjsh “snakes” më mbushje solare.

Kompania Flomed SHPK nga Prishtina ka ofertuar më këto 2 preparate larguesish të gjarpinjve që kanë ISO standard dhe Certifikata valide importuese ndërkombëtare.

Kompania e Doctor exterminator SHPK ka ofertuar me preparatin që e ka një Leje të notifikuar nga Ministria e Ambientit, që është e lëshuar dhe që ka përbërës të ndaluar ndërkombëtarisht nga OBSH (NAFTALINË DHE SULFUR), produkte këto kimike mjaftë të rrezikshme për njeriun dhe kafshët, por që POLICISË me këto veprime po tingëllon se nuk i intereson mbrojtja e punëtorëve të vet (rreth 10 mijë policë dhe shumë qenë policorë që i posedon Policia.

Pra, Doktor exterminator SHPK nga Prishtina, ofron preparatin repellent më emrin gjenerik “Snake-A Way”,që ka përmbajtje kimike Sulfur dhe që është një materie aktive e rrezikshme (kancerogjene) më këtë përqindje Sulfur: 28% dhe Naphtaline 7%. (Ky preparat ka mund të sjellët në Kosovë deri më datën e shfuqizimit të Ligjit mbi Produkte biocide).

Sipas Data sheetit të ofruar :“Snake-A Way”, nga kompania Doktor exterminator SHPK Prishtinë , e lëshuar para 8 (tetë vjetëve) më datën: 5 janar 2015 e ka këtë përqindje kimike:

Snake-A Way”,	SULFUR 15-40%
Snake-A Way”,	NAFTALINË 5-10%

OSHP le ta shikon dokumentin që ka ofertuar kompania në Dosjen tenderuese më numër : **214-22-5200-2-1-1 ; Nr.i brendshëm:214/22/078/211, në data shetti** prej faqës : së 3 –të , deri në faqen e 13 -të ofruar është shumë diskutabile .

Ky preparat është përdorur nga viti 1948 e deri në Luftën e Gjirit. Këtë preparat repelent e ka miratuar për një kohë **Agjencia farmaceutike amerikane EPA**, që ka qenë i patentuar kundër gjarpijve. Ai preparat ka qenë i miratuar nga natyralistët, konservatorët, ekologë e kanë përdorur.

Efikasiteti kundër gjarpinjve në luftën e Gjirit ka qenë 83 përqind në testimet laboratorike dhe testimet në teren që i kanë bërë të katër degët e ushtrisë amerikane, por një numër ushtarësh janë sëmurë nga kanceri.

Sipas studimeve amerikane ky preparat ndikon në sistemin nervor të gjarpinjve dhe në rruzat e kuqe të gjakut tek gjarpinjt 1%, njeriu dhe kafshët.

Naftalina, është produkt i paqëndrueshëm më përbërës aktiv të **“Snakes-A Way”**, (SAW) i cili avullon, dhe i njëjti futet në receptorin ndijor sipas **dr.amerikan Jacobson**) duke krijuar një ndërhyrje të menjëhershme që është mjaft represive për ta mbyllur sistemin shqisor, pra era kotërbuese e ka tremb gjarpërin e rërës **Neperka** dhe **Kobra** në Luftën e Gjirit.

6

Snake A-Way, dhe shumë produkte tjera repellent që u zhvilluan nga Farmacistë (shpikës është zoologu dhe farmacisti amerikan **B.Tennyson**) që bëri testimin e pothuajse 10 vjetë.

Shkencëtarët amerikanë dhe rus duke u hulumtuar dhe testuar, zhvilluan këtë produkt deri në vitin 2019 si produkt Unik amerikan kundër gjarpinjve.

Këtë testim e ka kryer edhe shkenctari amerikan **Dr.Hervev Lillwhite**, një zoolog i njohur i Universitetit të Floridas në USA. Pra **SAW** është një preparat i neveritshëm, irritues më substance të ndalaura Naftaline dhe sulfuri, më një erë të fortë që është e ndaluar nga OBSH, por çuditërisht jo e ndaluar nga AK dhe MMPH.

Reptologët e Universitetit të Floridas në USA, **Dr.Lillywhite**, ekspert i njohur në botë thotë se “” përbërësit e Sulfurit dhe Naftalinës janë kancerogjene”.

Kjo mund të gjindet edhe në faqet zyrtare “**NJ Health New Jersey Dpartment of Health Fire Hazardous Substantce Fact Sheetdous Substante Fact Sheet**”. Por çuditërisht “Sulfurin” dhe “Naphhtinen” që janë të NDALUARA rreptësisht po mendojnë ta përdorin, në Kosovë ngase këto produkte kanë përbërës kimikë më indikacione të rrezikshme për biodiversitetin njerëzor, botën shtazore (qentë në Stacionet policore në “K9” -në Lebane, në Kampin e Njësiave Speciale për Qejë në Vrellë, në Kampin e NJS “K9” në “Belvedere” të Mitrovicë si dhe në disa Pikat kufitare (në të ashtuquara “Zona të e gjelbërta” ku janë të vendosura) Shtëpizat e qejve policorë (“K-9”). Edhe studiues tjerë kanë demonstruar testime dhe eksperimente të mëvonshme në ca specije tjera dhe është gjetur një shkallë e ndjeshmërisë e cila variron prej 17 deri 100% në varësi të specieveve individuale :87,5% tek gjarpri *agkistrodon centotrix* më kokë ngjyrë bakri;75% *Coluber Black Racer*, 17% *Elophe guttata* gjarpër misri ose miu I kuq;47% *Elaphe obsolete* Gjarpër në formë të miut të verdhë etj.

Materie kimike (Naftalina dhe Sulfuri) janë mjaft të rrezikshme (helmuese) për ti përdorur dhe se prej tyre fitohet kanceri i gjakut në njerëz dhe kafshë..

Pra, Produkti i ofertuar që e ka pranuar Komisioni vlerësues i Prokurimit Publik të Kosovës "Snake-A Way", nga "Kompania Doktor exterminator SHPK", e cila po e rrezikon dukshëm shëndetin e pjesëtarëve policor si dhe Stafin civil ngase ky preparat është në kundërshtim me Nenin 29 të Ligjit nr.08/L-065 për Produktet Biocide, nenit 08/L-197 për kemikate dhe nenit Nr.08/L-116 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-197 për kemikate ngase produktin e ofruar sipas kushteve të parapara në Listat shëndetësore të data sheteve të sigurisë në Unionin Evropian dhe SHBA(USA) preparatet që janë më përberje të sulfurit dhe naftalinës janë të dëmshme për "carcinoma shtazësh dhe të Njeriut-.

Shif dokumentin e vjetruar (nga prilli i vitit 2000 që është reviduar më vonë në muajin Shtator të vitit 2008, nga Agjencitë amerikane DOT, IARC dhe EPA për Sodium Hypochlorite dhe Naftalinë.

Këtë gjë Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka qenë dashtë ta verifikojë zyrtarisht nëpërmes Departamentit të Tregtisë në Ambasadës Amerikane, në Prishtinë duke kërkuar shpjegim zyrtar që Ambasada të kontaktojë nëpërmes Polson control:1-8000-222-

7

1222; Chemtrec 1-800-424-9300, NJDEP hotline:1-877-927-8337; Cas Nr:7681-52-9; RTK Substante number:1707; DOT Number UN-1792 ; 1 tek AIHA: The American Industrial Hygiene Asociaton recomands a Workplace Enviromental Exposure Lovel(ëeel) of 2 mg/m2 foor a 15 minute work period, dhe ti jipet verdikti zyrtar nga USA.

Pra, AK ka bërë shkelje të nenit 28 të Specifikimeve teknike, sese pranon preparate të NDALUARA më ligj, nga një Kompani shumë e pa përgjegjshme !

Është kërkuar në dosjen Tenderuese për DEZINFEKTIM :

6.0 g didecyldimethylammonium chloride 5.5 g N,N-Bis(3-aminopropyl)-dodecylamine 4.2 g coco propylenediamine-1.5-bis-guanidinium acetate.
Emri fabrikor i këtij preparati është "Deconex 50 AF", që ka këtë përmbajtjen kimike:

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë “Doctor extreminator SHPK ka ofruar preparatin kimik jo analog me këtë përmbajtje kimike:

100 gram contains ka : 9,9 didecyldimethylammonium chloride and auxillary on the surfaces.

Ky preparat Dezinfektues është i distributorit “Eramed” Prishtinë, me emrin “**Ultrasol active**” i prodhuesit “**Dr.Schumacher**” me data sheetin e para 17 viteve, pra të vitit 2006-të, me kod të produktit 00320-0314-GHS faqe 1-10 i cili është një **Dezinfektues iritues** sipas rregullave sanitare të Unionit Evropian (EC) Nr.1272/2008, Harard kategorië:Oxidising solid,ox sol.2 .

Edhe ky **Dezinfektues** nuk është i ngjashëm me preparatin e kërkuar: **6.0 g didecyldimethylammonium chloride 5.5 g N,N-Bis(3-aminopropyl)-dodecylamine 4.2 g coco propylenediamine-1.5-bis-guanidinium acetate.** Siç është specifikuar në dosje të tenderit përkatësisht tek specifikimet teknike dhe se i njëjti nuk është i ngjashëm as me më përbërësit kimik (specifik) që janë të kërkuara më dosjen të tenderit.

Kur analizohen dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë shihet qartë se i njëjti vetëm ka prezantuar dokumente të cilat nuk kanë të bëjnë fare me këtë aktivitet të prokurimit, mirëpo këto dokumente janë prezantuar në ofertë me arsyen e vetme që të duket oferta e të njëjtit më e plotë dhe ti vështirësojë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave autoritetit kontraktues.

Pra edhe një herë po e sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë, ka ofertuar më 3 produkte Dezinfektuese që nuk janë as të përafërt me produktet dezinfektuese që ka kërkuar autoriteti kontraktues. **6.0 g didecyldimethylammonium chloride 5.5 g N,N-Bis(3-aminopropyl)-dodecylamine 4.2 g coco propylenediamine-1.5-bis-guanidinium acetatë.**

Edhe në këtë rast autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 28 të LPP-së për Specifikime teknike, sepse gjatë vlerësimit të tenderëve është dashur të ftohën ekspertët teknikë të diplomuar në degët e inxhinierisë kimike, teknologjisë kimike, biologët, agronomët, veterinarët dhe mjekët (epidemiologët dhe specialistët për higjienë), për faktin se sipas ligjit për produkte biocide nuk është zbatuar neni 7, pika 1,2,3 4 për produktin gjëja biocid që ka predispozicion negativ në shëndetin njerëzor , të mjedisit (tokës dhe ujit) si dhe atë të kafshëve, konform Direktivave 2006, Direktivës 2006/118/EC, Direktivës 2008/56 EC të datës 17 .06.2008. (Pra e kemi fjalën për produktin e ofruar për largimin e gjarpinjve me emrin fabrikor “**Snake-A Way**”, shumë të rrezikshëm).

Po ashtu, edhe për DEZINFEKTUESIN e kërkuar nga AK-ja më formulën kimike që ne si Oe i përgjegjshëm e kemi ofruar **6.0 g didecyldimethylammonium chloride 5.5 g N,N-Bis(3-aminopropyl)-dodecylamine 4.2 g coco propylenediamine-1.5-bis-guanidinium acetate.** Pra nga faktet e lartcekura kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti ka ofertuar me preparate për DEZINFEKTIM, të cilët nuk janë konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe specifikimeve teknike.

OE i rekomanduar për kontratë këto preparate me të cilat ka ofertuar nuk i ka të notifikuara nga Ministria e Ambientit dhe nuk posedon leje për përdorim nga kjo Ministri, por Leja të

9

cilën e ka prezantuar është e një kompanie krejt tjetër e cila nuk është në konzorcium me OE të rekomanduar për kontratë, pra është fjala për kompaninë Eramed. Nuk mund të përdoret leja e një kompanie nëse nuk është në konzorcium, prandaj OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Duhet cekur fakti se në këtë aktivitet të prokurimit para hapjes së ofertave është larguar një kërkesë specifike dhe shumë e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij procesit të prokurimit, përkatësisht kërkesa në lidhje me kërkesën “Specialist Epidemiolog”. Largimi i kësaj kërkesë nga dosja e tenderit, të cilën kërkesë vet autoriteti kontraktues e kishte përcaktuar në dosje të tenderit, neve na bën të dyshojmë edhe më shumë se ky aktivitet i prokurimit është përcaktuar për OE të rekomanduar për kontratë. Këto dyshime po i parashtrojmë për faktin se kërkesën në lidhje me epidemiologët nuk ka mundur ta përmbush vetë OE tani i rekomanduar për kontratë, pasi që vetë drejtori i kompanisë së OE të rekomanduar për kontratë nuk posedon licencën për epidemiolog. Thjesht ky tender është i kurdisur.

Repellimi dhe kontrolli i gjarpinjve (zvarranikëve). Duke u bazuar në ligjin për produkte biocide : <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61927>

LIGJI NR. 08/L-065 PËR PRODUKTET BIOCIDË, i datës : 19 gusht 2022 në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës , AK-ja si dhe Ministria e Ambientit Hapsinor nuk e ka zbatuar Ligjin për lejim të produktit repelent për gjarpinjë me emrin fabrikor “***Snake-A Way***”, **shumë të rrezikshëm andaj shpresojmë që këto fakte shkencore të demantohen në praktikën e tij eksperimentale në Policinë e Kosovës.**

AK ka bërë shkelje të Nenit 28 të Specikimeve teknike. Njësia kërkuese, përkatësisht departamenti shëndetësor si dhe departamenti i prokurimit, herën e parë me rastin e publikimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka kërkuar repelentin në formë pluhuri (Snakes repellent) që deri në muajin qershor 2022 Ministria e Ambientit ka lëshuar leje notifikuese për import, e të cilën Leje e kemi pasur edhe ne, si dhe OE Doktor Extreminatorit SHPK që e ka ofruar dokumentin e noterizuar nga Ministria mjedisit dhe planifikimit Hapsinore. Pas një ankese të një OE, AK-ja ka ndryshuar kërkesën dhe ka ndryshuar Specifikimin për largimin e zvarranikëve (gjarpinjve) duke kërkuar aparatura speciale për largimin e gjarpinjve më snakes solare (diellorë) ose Snakes më bateri, e me të cilat aparatura kemi ofertuar edhe ne si OE i përgjegjshëm, pra kemi ofertuar me aparaturën për largimi e gjarpinjëve solarë dhe me bateri, ndërsa Operatori i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me preparat të ndaluar ndërkombëtarisht, siç edhe e kemi cekur më lartë. OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me preparatin “**Sake-A-Way**” e i cili preparat është i ndaluar sipas Ligjit mbi produktet e notifikuara të Ministrisë së ambientit si dhe të WHO-së.

Sipas data sheetit kompania fituese ka ofruar data sheetin e dates **05.01.2015**, e i cili preparat “**Sake-A-Way**” ka këtë përmbajtje kimike:

Sulfur 15-40%,

Naftalinë 5-10% .

Preparati kimik për largim të gjarpinjve (zvarranikëve) “**Snake-A-Way**”, me të cilin ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë është një preparat kancerogjen dhe shumë i rrezikshëm për biodiversitetet (human dhe shtazorë), ngase është kancerogjen dhe nuk lejohet për përdorim në USA, Unionin Evropian. I njëjti lejohet vetëm në Jordan, Iran, Afganistan e në disa vende të Lindjes së Afërme dhe Azisë (Indi etj).

Preparati është një vrasës për njerëz dhe kafshë. Larguesi i zvarranikëve i përdorur më herët “Snake-A-Way”, është larguar nga përdorimi për shkak të materieve aktive

naftalinë, Sulfur dhe Naftalinë, substanca këto të rrezikshme kancerogjene, si dhe në kundërshtim më : <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61927>

LIGJI NR. 08/L-065 PËR PRODUKTET BIOCID, i datës 19.08.2022. Pra OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar në kundërshtim me rregullat sanitare të Kosovës dhe të OBSH-së, ndërsa me rekomandimin për kontratë të këtij OE edhe AK-ja ka bërë shkelje të ligjit të lartcekur dhe rregullave sanitare të Kosovës dhe të OBSH-së.

Për të sqaruar sa më qartë përbërjen e produkteve me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë ju sqarojmë se: Shkencërisht, Naftalina është një përbërës jo i mirë në formën e një substance që është e bardhë më një aromë shumë të keqe dhe të fortë. *Kimistët dhe teknologët e njohin naftalinën, që është përdorur kundër molave dhe për të larguar insektet dhe zvarranikët, por është shumë i dëmshëm për organizmat e gjallë : njeriun dhe shtazët (qentë, lopët, kuajt etj). Ajo njihet si një pesticid që nga viti 1948. Për më tepër, ashtu si pesticidet e tjera, naftalina nuk është e sigurt për Policinë, sidomos kur është e ekspozuar në hapësirat ku jetojnë dhe shërbejnë 7/24 orë në javë Policia „Stafi civil dhe i uniformuar së bashku me kasollat e qejve (K-9).*

Sqarim: Pse naftalina është e rrezikshme?

Naftalina mund të shkatërrojë ose të ndryshojë qelizat e kuqe të gjakut. Kështu, ata nuk do të jenë në gjendje të mbajnë oksigjen, të cilat mund të çojnë në dëmtime të organeve.

Një nga shenjat e menjëhershme të helmimit me naftalinë është dhimbja e stomakut, por zakonisht kjo shfaqet dy ditë më pas, së bashku me diarrenë dhe vjelljen. Disa njerëz kanë ethe dhe shenjat bëhen më keq me kalimin e kohës, të cilat mund të përfshijnë:

Dhimbje koke, Presion të ulët të gjakut, Verdhëz (hepatit), Probleme me frymëmarrjen, Probleme urinare më veshka Për fat të keq, disa njerëz përfundojnë në koma pasi helmohen me naftalinë. Për më tepër, njerëzit që kanë mungesë glukoza-6-fosfat dehidrogenazëm.

Atomët e squfurit formojnë molekula ciklike tetë atomike me formulë kimike

Ajo është një organizatë jo-dritë metali aspekt të verdhë të cilat mund të kombinohen me hidrogjen të sulfide hidrogjeni është një gaz helmues që ka një erë karakteristike e vezëve kalbura. Ajo digjet me një flakë blu që lëshon një erë të veçantë mbytës (dioksid squfuri SO₂).

Squfurit është i patretshëm në ujë por është i tretshëm në (bi-) disulphide karboni (CS₂).

Gjendja e oksidimit të sqfurit më të zakonshme janë -2, 2, 4 dhe 6. Polimere të sqfurit nitride pronave metalike edhe pse ato nuk përmbajnë atom metali, prona ky kompleks ka gjithashtu elektrike dhe optike të rralla.

Squfuri jokristalor ose "plastike" mund të prodhohen nga ftohje të shpejtë të sqfurit kulluar. Studimet rreze tregojnë se forma jokristalor përbëhet nga një strukturë spiral me tetë atomet sqfur për të kthehet.

Squfuri mund të merret në dy forma të kristaltë: octahedra orthorhombic, ose në prisms monoclinic, forma orthorhombic është më i qëndrueshëm në temperatura të zakonshëm. Gjindet i lire dhe i lidhur i lire gjindet ne afersi te vullkaneve kurse i lidhur gjindet ne forme te disa komponimeve a ato komponime jane ne forme te xeheve :

- Piriti Sfaleriti Galeniti Kripë gipsi ,Sulfati i bariumit

Sulfuri prej tokës nxirret me metoden e frashit me ane te gypit me piston .Ky ndryshe quhet lulja e sulfurit e pastër 99,6%.Gjindet ne tri forma alotropike :sulfuri rombik, sulfuri prizmatik, sulfuri gazamorf. Sulfuri eshte substance e ngurte me ngjyre te verdhe nuk tretet por mire tretet ne disulfurin e karbonit

Përdorimi

Ai gjen përdorim kryesisht tek prodhimi i acidit sulfurik për plehrat kimike (fertilizuesit) me suflate dhe fosfate. Sqfuri është përdorur kryesisht në:

- *barut, laksativë dhe shkrepse, insekt- dhe kërpudhë vrasës në industrinë bujqësore, pigmentet natyrale për ngjyrim, vullkanizimi i gomave, përdorim mjekësor për përfitim të barnave*
- *dhe deri në vitin 2020 është përdorë në repelimin e gjarpirjeve, por OBSH këtë product e ka ndaluar rreptësisht.*

*Poashtu edhe **Sqfuri** është një element kimik. Në trupin e njeriut paraqitet me një përqindje prej afro 0,25%, sasi e cila ndodhet e shpërndarë në proteina dhe një pjesë ndihmon në miksien e gjakut. Është gjithashtu shkaktari i erës së keqe të gazrave trupore, vezëve të prishura apo pellgjeve me ujë të ndjenur. Sulfuri gjendet me shumë se 30 modifikime alotropike po vetëm dy janë më të rëndësishme sulfuri romboik dhe ai monoklinik.*

*Sqfurit është një element kimik në chalcogen familjes, simbol **S** dhe numrin atomik 16.*

Ai është një element pa erë, pa shije dhe i bollshëm në koren e tokës, nuk tretet në ujë.

Sqfuri është i njohur mirë si kristalet e verdhë dhe të gjendet në shumë minerale (sulfide dhe sulfate) dhe madje edhe në formë të pastër, veçanërisht në rajonet vullkanike. Shumica e sqfurit të përdorur, megjithatë, është me origjinë sedimentare. Në ditët e sotme, pothuaj gjithë sqfuri prodhohet si derivat i ndotësve me bazë sqfuri nga nafta dhe gazi natyror.

Sqfuri është një element thelbësor për të gjitha krijesat e gjalla por gjithmonë në formën e përbërjeve organike ose sulfideve të metaleve. Amino acidet dhe dy vitamina (biotina dhe tiamina) janë përbërje organosulfurike të pazëvendësueshme për jetën.

Gjithashtu shumë koofaktorë gjithashtu përmbajnë sqfur.

Disulfidet, lidhjet S-S, i japin fortësi dhe patretshmëri proteinës së keratinës, e gjetur në lekuren e jashtme, flokë dhe pupla.

Mund të themi se sqfuri është një nga elementët thelbësorë për funksionet biokimike dhe është një makronutrient për të gjithë organizmat e gjallë. Preparati i ofruar nga Doctor exterminator SHPK

*Më emrin **“Snake-A-Way”** ka substance kimike kancerogjene e ndaluar nga OBSH (Organizata botërore e Shëndetësisë dhe nuk është Product biocid, por është product*

mjaftë I rrezikshëm për shëndetin e njeriut dhe kafshëve në këtë rast qejtë në STacionet Policore “K9”(në Policinë e Kosovës).

Pra edhe këtu bëhet shkelja e Nenit 28 e Specikimeve teknike.

Ka mënyra më efektive për të hequr qafe gjarpërinjtë se sa mbytja - këto janë repelente moderne dhe mjete juridike popullore të provuara.

Një zgjidhje shumë më efektive për problemin janë frikësuesit specialë. Pajisja është jashtëzakonisht e thjeshtë dhe e besueshme. Çmimi është i përballueshëm.

Thjesht duhet të mbërthehet në tokë pranë një zone që gjarpërinjtë mund të pëlqejnë. Një pajisje mbulon një sipërfaqe prej 300–600 m², 800 m².

burimi i energjisë është panelet diellore.

Efekti pozitiv sigurohet nga ultratingulli, vibrimi ose një kombinim i tyre, ku ne si kompani Flomed SHPK kemi ofertuar me preparatet e tilla (diellor-solarë dhe më bateri).

Gjarpërinjtë kanë organe dëgjimi shumë të zhvilluara dhe të ndjeshme, por zhurma nuk perceptohet si zë, por si dridhje.

Ata nuk mund të përshtaten me valët e gjeneruara nga pajisja për shkak të ndryshimit të frekuencës së tyre, prandaj detyrohen të largohen nga vendi.

Thjeshtësia e dizajnit të repeluesve të gjarpërinjve përcakton kryesisht besueshmërinë e tyre.

Modelet më të njohura janë:

- Weitech-WK677 Solar;
- EcoCnayer LS-107;
- NDIHMË nga gjarpërinjtë;
- Tornado B03.01;
- Uniel UDR-S20.

Kimikatet –Helmet “efektive” të naftalinës dhe sulfurit, kundër repelimit të gjarpinjëve.

Naftalina si përbërës i rrezikshëm, në formën e një substance të bardhë që ka një aromë të keqe dhe të forte. Ekspertët (kimistët, ekologë, agronomët, mjekë e epidemiolog, infektologët etj) e kanë të njohur që dikur moti në shekullin e kaluar e kanë përdorur kundër molave dhe për ti larguar insektet dhe zvarranikët Ajo njihet si një Pesticid që nga viti 1948.

13

Për më tepër, ashtu si pesticidet tjera, Naftalina nuk është i sigurtë për repelim të gjarpirjeve, sidomos kur ky preparat është i ekspozuar në hapsirat ku jetojnë kafshet dhe njeriu.

Pse naftalina është e rrezikshme ?

Naftalina mund të shkaktojë ose të ndryshojë qelizat e kuqe të gjakut (eritrocit).

- *Kështu at nuk do të jenë në gjendje të mbajnë Oksigjenin (O₂), të cilat mund të qojnë në dëmtimin e organeve (Karcinoma tek njeriu dhe kafshët) në këtë rast të policët e Kosovë dhe qejtë në Stacionet policore të ashtuquajtura "K-9".*
- *Helmimi më naftalinë zakonisht mund të ndodhë tek fëmijët, barijtë, që aksidentalisht mund të konsumojnë topa naftaline, por nuk do të thotë që edhe të rriturit (policia) ose qentë e "K-9" të gëlltisnin preparatin e ndaluar nga viti 2020).*

Preparati sipas Metodologjisë së vjetër të kësaj kompanije "shpërndahet rreth një perimetri 15x 15 metra të vendit duke e "rrethuar" vendin potencialisht tërheqës për zvarranikët (apo ku dalin të njëjtë).

Në kufijtë rreth zonës, formohen brazda të cekëta dhe derdhen me këto kimikate ose shpërndahen topa të thatë naftaleni. Por kini parasysh se pas shiut ata do të lahen dhe se ku do të rrjedhë uji, i cili është shumë i dëmshëm për tokën, është e vështirë të parashikohet.

Kur punoni me ndonjë kimi, kujdesuni për pajisjet mbrojtëse (syze, doreza, respirator, kapele, mëngë të gjata, këpucë të papërshekueshme nga uji).

Helmet e forta të sulfurit dhe Naftalinës (**Snake Repelling** “**Snake-A-Way**”) nuk mund të përdoren për të hequr qafe gjarpërinjtë. Duhet mbajtur mend se gjarpërinjtë janë kafshë grabitqare, ata nuk do të hanë ushqim të palëvizshëm. Në vend të kësaj, është më mirë të përdorni substanca me erë, ato do të shpëtojnë njëkohësisht ekologjinë përreth dhe do të trembin jo vetëm gjarpërinjtë, por edhe shumë dëmtues të tjerë.

Vlen për tu theksuar që më shumë suksese për disa vjetë i kemi kryer këto shërbime të DDD-së më kontroll të shpendeve dhe zvarranikëve më mjaftë suksese në të gjitha Stacionet Policore të Kosovës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, AKPM, QKUK, Spitalin Amerikan, Spitalet tjera anë e kënd vendit etj. Provat më të mira për këto shërbime janë Referencat, kontrata e shumta.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktet e mëposhtme:

Në dosjen tenderuese është kërkuar Insekticidi(Dezinsektuesi-Insekticidi) që ka këtë përmbajtje kimike:

Cypermethrine 8.0gr (92 g / litre),

Tetramethrin 2,0gr(23 g / litre),

Piperonyl Butoxide 10,0 g(115 g / litre)

Emri fabrikor i këtij produkti është : “Foval CE”(shif dokumentin) dt.23.11.2022 i lëshuar nga Fabrika me validitet deri më dt.31.12.2024 që e ka ofertuar kompania Flomed SHPK Prishtinë.

Shif në google:

<https://www.nexles.com/eu/kollant-insecticide-foval-ce-1-litre.html>

Emri gjenerik(fabrikor I prepartit) eshte “Foval Ce “ më të cilin kompania Flomed SHPK ka konkuruar sipas dosjes tenderuese .

OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me preparate tjera të cilat nuk janë të ngjashme me ato që janë kërkuar në dosje të tenderit - *krejtësisht tjera insekticide(jo analoge) .*

Siç edhe e cekëm më lartë në dosje të tenderit është kërkuar:

Cypermethrine 8.0gr (92 g / litre),

Tetramethrin 2,0gr(23 g / litre),

Piperonyl Butoxide 10,0 g(115 g / litre)

Piperonyl Butoxide 10,0 g (115 g / litre)

Emri fabrikor i këtij produkti është : “Foval CE”(shif dokumentin) dt.23.11.2022 i lëshuar nga Fabrika me validitet deri më dt.31.12.2024 që e ka ofertuar kompania Flomed SHPK Prishtinë.

Shif në google:

<https://www.nexles.com/eu/kollant-insecticide-foval-ce-1-litre.html>

Emri gjenerik(fabrikor i prepartit) eshte “Foval Ce “ më të cilin kompania Flomed SHPK ka konkuruar.sipas dosjes tenderuese .

OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me preparate tjera të cilat nuk janë të ngjashme me ato që janë kërkuar në dosje të tenderit - *krejtësisht tjera* insekticide(jo analoge) .

Siç edhe e cekëm më lartë në dosje të tenderit është kërkuar:

Cypermethrine 8.0gr (92 g / litre),

Tetramethrin 2,0gr(23 g / litre),

Piperonyl Butoxide 10,0 g (115 g / litre)

Që e ka emrin gjenerik(fabrikor) ”Foval CE” të Fabrikës “Kollant”, Italy.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me disa preparte krejtësisht tjera që përdoren kundër insekteve fushore (riqnave) grunaje dhe vende ku ka rriqra endemike më emra fabrikor të preperateve si vijon:

1. **“AQUA K Othrine EE 20”(12x 1 lit BOT BLK)** me kodin e produktit **80234791** më këtë përmbajtje kimike si vijon:

Delthamethrin 2% ,

Hydrokarbons C10-C13,

aromatics <1%,

naftaline 2-50-<25%;

steryl alkool .1,00-
ethoxylated 5%,

1,2 benzisothiazol-3(2H)-one,0,05-,0,05%

Etj, të cilat nuk janë preparate anologe më preparatin e kërkuar nga Njësia Kërkuese e AK që duhet të jetë sadopak e përafërt më preparatin Foval Ce .

Autoriteti kontraktues edhe pas kërkesës tonë për rishqyrtim ku e kemi sqaruar qartë përgjegjëshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë e njëjta nuk i pranon gabimet e saj dhe përsëri pas rishqyrtim e refuzon kërkesën tonë për rishqyrtim , pa ndonjë bazë konkrete të mbështetur në dispozita konkrete ligjore.

Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje Nenit 69:Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale.

E njëjta nuk e ka respektuar nenin e lartpërmendur sepse dëshmitë e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk janë konform kërkesave tek specifikimet teknike të detyrueshme, mirëpo edhe përkundër këtij fakti AK-ja e ka rekomanduar për kontratë OE i cili është i përgjegjshëm. Specifikimet teknike nuk janë harmoni me data shete dhe nuk posedojnë Licenca konform ligjit për preparatet dezinfektuese, insecticide dhe repeluese për gjarpinjë, si dhe metodologjia nuk është shkencore.

Po ashtu katalogu i prezantuar është i mangët i Aparaturës së makinave spërkatëse, si dhe certifikatat e analizave të kërkuara për dezinfektues dhe insecticide nuk janë për preparte të specifikuar në doje të tenderit.

Bashkangjitur keni edhe Vendimin për refuzim me nr.prot.4495-22 i dt.09.08.2022 nga MMPHI dhe vendimi nr.5525/22 i dt.28.09.2022 për preparatin Kalif Reptiles 600 gr dhe Rettil stop 600 gr të cilët përmbajnë sulfur dhe naftalinë, ku me këto vendime janë refuzuar kërkesat tona për import dhe dalje në treg të këtyre produkteve biocide. Dhe pse i kemi poseuduar lejet nga kjo Minsitri me nr.22/1846/-1-ZSP të dt07.06.2022 dhe të dt.12.07.2022, si dhe me NR.22/6162/-1-ZSP të dt.20.09.2022.

Këto dokumente nuk janë bashkangjitur për shkak se lëter autorizimi nga fabrika ADAMA-Itali i dt.25.11.2022 nuk e mkan pasur preparatin biocid të lejuar me Kalif Verechome Garden 35 gr me kod:1866/1846/22/KOS.

Nag këto dëshmi parashtrohet pyetja se si është e mundur që preparati që ka Naftalinë dhe Sulfur ti lejohet OE të rekomanduar për kontraë nga MMPHI, ndërsa neve të mos na lejohet.

Ne me dt.11.05.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja e ka cekur se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo nuk ka dhënë ndonjë fakt apo arsye konkrete për një refuzim të tillë.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim i ka përsëritur dispozitat ligjore të cilat ne kemi dhënë fakte konkrete se të njëjtat nuk janë respektuar, ndërsa e njëjta e ka cekur se kinse janë respektuar dispozitat ligjore dhe se kinse aktiviteti i prokurimit është zhvilluar duke i respektuar dispozitat ligjore.

AK-ja në vendimin për refuzim ka dhënë arsyetimin si në vijim:

OE i rekomanduar për dhënie DOCTOR EXTREMINATOR DDD SHPK për largimin e zvarranikeve ka ofertuar me Preparate repelente ekologjike në formë të granulave me efektivitet optimal komfor specifikacioneve teknike të detyrueshme të DT.

OE i rekomanduar posedon leje me validitet të lëshuar nga MMPH, në numër protokolli 2940/22 me datën 24.05.2022 për import dhe dalje në treg të Produkteve biocide ku produkti Snake – A- Way – Snake – repelling Granules me numër notifikimit 1894/2940/22/KOS është i lejuar të përdoret në Kosovë. Gjithashtu AK ka marrë përgjigje zyrtare nga MMPH ku thuhet se përdorimi i preparateve repelente në formë të granulave është i lejuar në Republikën e Kosovës sipas standardeve të BE- se.

OE i rekomanduar ka ofertuar me preparate ekuivalente për Dezinsektim dhe Dezinsektim sipas specifikacionit teknik të detyrueshëm të DT.

Arsyetimi i lartcekur i AK-së është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm për faktin se ne e kemi sqaruar shumë qartë edhe më lartë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar data sheetin e datës **05.01.2015**, e i cili preparat "**Snake-A-Way**", ka këtë përmbajtje kimike:

Sulfur 15-40%,

Naftalinë 5-10%.

Preparati kimik për largim të gjarpinjve (zvarranikëve) "**Snake-A-Way**", me të cilin ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë është një preparat kancerogjen dhe shumë i rrezikshëm për biodiversitet (human dhe shtazor) dhe nuk lejohet për përdorim në USA dhe Unionin Evropian. I njëjti lejohet vetëm në Jordani, Iran, Afganistan e në disa vende të Lindjes së Afërme dhe Azisë (Indi etj).

Preparati është një vrasës për njerëz dhe kafshë. Larguesi i zvarranikëve i përdorur më herët "**Snake-A-Way**", është larguar nga përdorimi për shkak të materieve aktive naftalinë, Sulfur dhe Naftalinë, substanca këto të rrezikshme kancerogjene, si dhe në kundërshtim me **LIGJIN NR. 08/L-065 PËR PRODUKTET BIOCIDET**, të datës 19.08.2022.

Pra OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar në kundërshtim me rregullat sanitare të Kosovës dhe të OBSH-së, ndërsa me rekomandimin për kontratë të këtij OE edhe AK-ja ka bërë shkelje të ligjit të lartcekur dhe rregullave sanitare të Kosovës dhe të OBSH-së.

AK-ja e ka cekur se kinse produkti me të cilin ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë është i lejuar për përdorim në Kosovë, mirëpo nuk ka prezantuar asnjë fakt apo dëshmi konkrete se një preparat i tillë nuk është i dëmshëm.

Pra AK-ja nuk i kundërshton me asnjë arsyetim, pretendimet tona ankimore ku e kemi qartësuar me fakte konkrete se përse produkti me të cilin ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë është i dëmshëm/kancerogjen.

Duhet cekur fakti se helmet e forta të sulfurit dhe Naftalinës (Snake Repelling "Snake-A-Way") nuk mund të përdoren për të hequr qafe gjarpërinjtë. AK-ja dhe ne të gjithë e dimë se gjarpërinjtë janë kafshë grabitqare dhe ata nuk do të hanë ushqim të palëvizshëm. Në vend të kësaj, zgjidhja më e mirë është të përdoren substanca me erë, të cilat do të shpëtojnë njëkohësisht edhe ekologjinë përreth dhe do të trembin jo vetëm gjarpërinjtë, por edhe shumë dëmtues të tjerë, mirëpo në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të lejohen produktet e rrezikshme me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë të cilat mbajnë naftalinë dhe sqfur.

Po ashtu AK-ja e ka cekur se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me preparate ekuivalente për Dezinsektim dhe dezinfektim, mirëpo edhe ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar dhe për më tepër është veprim favorizues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë i cili edhe pse është i papërgjegjshëm, po favorizohet nga AK-ja.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me preparate tjera të cilat nuk janë të ngjashme me ato që janë kërkuar në dosje të tenderit - *krejtësisht tjera* insekticide.

Ne edhe një herë po e sqarojmë se në dosje të tenderit është kërkuar:

Cypermethrine 8.0gr (92 g / litre),

Tetramethrin 2,0gr(23 g / litre),

Piperonyl Butoxide 10,0 g (115 g / litre)

Emri gjenerik (fabrikor) "Foval CE" të Fabrikës "Kollant", Italy.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me disa preparate krejtësisht tjera që përdoren kundër insekteve fushore (riqnave) grunaje dhe vende ku ka rriqra endemike më emra fabrikor të preparateve si vijon:

1. **"AQUA K Othrine EW 20"** (12x 1 lit BOT BLK) me kodin e produktit 80234791 më këtë përmbajtje kimike si vijon:

Delthamethrin 2%,

Hydrokarbons C10-C13,

aromatics <1%,

naftaline 2-50-<25%;

steryl alkool .1,00-,

ethoxylated 5%,

1,2 benzisothiazol-3(2H)-one, 0,05-, 0,05% etj, të cilat nuk janë preparate të njëjta me preparatin e kërkuar nga AK-ja Foval Ce.

AK-ja e ka cekur se preparatet e OE të rekomanduar për kontratë janë ekuivalente, pra nuk janë të njëjta siç është kërkuar andaj në këtë rast kuptohet se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me variante dhe jo me produkte të njëjta siç është kërkuar në dosje të tenderit.

Tek dosja e tenderit përkatësisht tek **neni 4.1** është specifikuar qartë se **variantet nuk janë të lejuara**, mirëpo edhe përkundër këtij fakti AK-ja po e rekomandon përsëri për kontratë këtë operator ekonomik duke e favorizuar haptas të njëjtin.

Duhet cekur fakti se AK-ja nuk i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tona ankimore, kundrejt OE të rekomanduar për kontratë.

Më poshtë po ji bashkangjesim përsëri pretendimet tona ankimore të cilat AK-ja nuk i ka shqyrtuar, pasi që nuk ka mundur të arsyetoj të kundërtën e pretendimeve tona ankimore.

Në dosjen e tenderit përkatësisht tek specifikimet teknike për DEZINFEKTIM është kërkuar :

6.0 g didecyldimethylammonium chloride 5.5 g N,N-Bis(3-aminopropyl)-dodecylamine 4.2 g coco propylenediamine-1.5-bis-guanidinium acetate.

OE i rekomanduar ka ofertuar me një preparat dezinfektues por jo më përmbajtje kimike të ngjashme me Deconex 50 AF (prodhuar Borer chemie AG, Seisss)

Preparati me të cilin ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë mban datën e para 3 viteve:

13 mars 2020, ky fakt vërtetohet nga fatura e ofruar të cilës i figuron emri i kompanisë "Eramed"-Prishtinë, e cila nuk është në Konsorcium më OE të rekomanduar për kontratë.

Dëshmia për këtë është Nr. i fatures : **nr.20-SHV01-001-524** si dhe një faturë të po këtij distributori që mbanë datën e lëshimit të skaduar i datës : **12 mars 2020** dhe Nr. faturës është si vijon: 20-SHV01-001-4959. Autoriteti kontraktues nuk e ka marr parasysh fare këtë fakt, duke e favorizuar OE të rekomanduar për kontratë, pasi që nuk ka dhënë asnjë arsyetim në lidhje me këtë pretendim tonin ankimor.

Preparati i lartcekur nuk ka Licencë notifikuese në emër të firmës "Dr.extreminator" SHPK, pra ne nuk e kemi cekur që OE i rekomanduar nuk ka prezantuar licencë, mirëpo e kemi theksuar qartë se licenca nuk është në emër të OE të rekomanduar për kontratë.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë "**Doktor exterminator ShPK**", ka ofertuar edhe më një preparat tjetër të 2-të, dezinfektues me emrin "**Actosul Flasche AF**" më përbërje kimike jo sipas specifikimit të specifikuar për dezinfektues siç është kërkuar në Dosje të tenderit:

Tek specifikimi teknik është kërkuar preparati dezinfektues më përbërje kimike : 6.0 g didecyldimethylammonium chloride 5.5 g N,N-Bis(3-aminopropyl)-dodecylamine 4.2 g coco propylenediamine-1.5-bis-guanidinium acetat.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë "Doctor extreminator SHPK ka ofruar preparatin kimik jo të me këtë përmbajtje kimike:

100 gram contains ka : 9,9 didecyldimethylammonium chloride and auxillary on the surfaces.

Ky preparat Dezinsektues është i distributorit "Eramed" Prishtinë, më emrin "Ultrasol active" i prodhuesit "Dr.Schumacher" me data sheet e para 17 viteve, pra të vitit 2006-të, më kod të produktit 00320-0314-GHS faqe 1-10 i cili është një Dezinsektues iritues sipas rregullave sanitarie të Unionit Evropian (EC) Nr.1272/2008, Harard categorinë: Oxidising solid,ox sol.2 .

Edhe ky Dezinsektues nuk është i ngjashëm me preparatin e kërkuar: 6.0 g didecyldimethylammonium chloride 5.5 g N,N-Bis(3-aminopropyl)-dodecylamine 4.2 g coco propylenediamine-1.5-bis-guanidinium acetate" në dosje të tenderit përkatësisht tek specifikimet teknike dhe se i njëjti nuk është i ngjashëm as me më përbërësit kimik (specifik) që janë të kërkuara më dosjen të tenderit.

Pra AK-ja nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona të lartcekura, pasi që nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore dhe me këtë veprim të saj edhe një herë po shihet qartë favorizimi që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë.

AK-ja tek vendimi për refuzim ka dhënë edhe një arsytim tjetër si në vijim:

Ndërsa sa i përket stafit të kërkuar nga AK : Minimum Tre (3) punëtorë teknik me eksperiencë në lemin e DDD-së. Me Dy (2) vite përvojë pune të dëshmuar me referencë . Me Kontratë pune ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin për angazhim për këtë projekt , OE në fjale ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme për stafin e kërkuar nga AK.

Arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se nuk ka dhënë asnjë dëshmi konkrete që e vërteton të kundërtën e pretendimit tonë ankimor, mirëpo vetëm e ka cekur se stafi i OE të rekomanduar për kontratë ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme sipas kërkesave të AK-së.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, **e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parashihet qartë që "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*".

Po ashtu AK-ja e ka favorizuar OE të rekomanduar për kontratë duke e shpall fitues edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm, ndërsa anë këtë rast ka rënë ndesh edhe me paragrafin 6 të nenit 7 pika (vi) ku shkruan që Autoriteti kontraktues duhet të sigurohet që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

Autoriteti kontraktues është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

KËRKOJMË QË KJO LËNDË TË SHQYRTOHET NGA NJË EKSPERT ME PROFESION KIMIST APO TEKNOLOG.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **Flomed SH.P.K.**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në **RIVLERSIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM



SPECIFIKACIONI TEKNIK I DETYRUESHËM

Dezinfektimi. - Duhet të bëhet me mjete bashkëkohore si Pompa Motorike ULV, me pajisje elektrike për mjegullim të ftohtë dhe me përmbajtje aktive të dezinfektuesve si Didecyldyoctyl ammonium chloride 6.0gr ose të ngjashme me efekt baktericid, fungicid, sporocid dhe virucid.

Lejohet për përdorim edhe preparati ekuivalent me efekt të njëjtë.

Të kenë A-testet e preparateve që përdoren për dezinfektim dhe lista e emrave të preparateve (preparatet të jenë ekologjike që mund të përdoren në hapësira publike të jashtme dhe të brendshme).

Preparatet duhet të jenë të aplikueshme përmes aparaturës ULV –ES. Elektrostatike (spërkatjeve në formë të njëtrajtshme).

Për çështje të sigurisë së tyre në lidhje me origjinën e produkteve tenderuesi dhe lejen për përdorim në RK, duhet të paraqesë edhe lejen e importit të produkteve të lëshuara nga Ministria e Ambientit Hapësinor.

Dezinsektimi. - Gjatë këtij procesi, të përdoren preparate të cilat kanë efekt eliminues dhe kontrollues ndaj insekteve.

Të bëhet me mjete bashkëkohore si Pompa Motorike ULV, aparatura të cilat krijojnë tym (fogër) si dhe tenderuesi duhet të ketë në dispozicion atomizer që përdoret për dezinfektim hapësinor.

Dezinsektuesit duhet të kenë në përbërjen e tyre substanca aktive si:

Cypermethrin 92 g/l

Tetramethrin 23g/l

Piperonyl butoxide 115g/l.

Lejohet për përdorim edhe preparati ekuivalent me efekt të njëjtë.

Të gjithë dezinfektuesit duhet të jenë ekologjik që të mos jenë të dëmshëm për individ dhe të jenë adekuat për të gjitha llojet e insekteve, zvarritëse dhe fluturuese.

Për çështje të sigurisë së tyre në lidhje me origjinën e produkteve tenderuese dhe lejen për përdorim në RK, duhet të paraqesë edhe lejen e importit të produkteve të lëshuar nga Ministria e Ambientit dhe Zhhyllimit Hapësinor në RK.

Deratizimi. - Për deratizim të objekteve të përdoret preparati deratizues Rodenticid – Antigoagulant i gjeneratës së dytë.

Preparati deratizues të vendoset në stacione të etiketuara dhe të bllobuara.

Përbërja e preparateve është kjo:

Bromadiolone 0.005 %.

Bradifacoum 0.005% .

Këto preparate mund të jenë edhe në formën e drithërave si gruri, peleti dhe formë briketi.

Lejohet për përdorim edhe preparati ekuivalent me efekt të njëjtë.

Të gjithë rodenticidet duhet të jenë të shoqëruara me dokumentacion përkatës si listë të sigurisë teknike dhe certifikatë të analizave.

3_Ng Dosja e Tenderit për Kontratën Publike Kornizë – Shërbim Me Një OE

18

Për çështje të sigurisë së tyre në lidhje me origjinën e produkteve tenderuese dhe lejen për përdorim në RK duhet të paraqesë edhe lejen e importit të produkteve të lëshuar nga Ministria e Ambientit Hapësinor në RK.

Largimi i zvarranikëve – Për kryerjen e këtij shërbimi të përdoret njëri lloj i këtyre aparateve apo vetëm granulat.

1 - Aparate me vibrim për dëbimin e zvarranikëve me bateri që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 300 - 400 m² për largimin e Zvarranikeve, të qëndrueshëm ndaj lagështisë. ose

2 –Aparate solare me vibrim për dëbimin e zvarranikëve që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 600 – 700 m² për largimin e Zvarranikëve të qëndrueshëm ndaj lagështisë.

3 – Preparate repelente ekologjike si granula për largimin e zvarranikëve me efektivitet optimal.

Për çështje të sigurisë së tyre në lidhje me origjinën e produkteve tenderuese dhe lejen për përdorim në RK, duhet të paraqesë edhe lejen e importit të produkteve të lëshuar nga Ministria e Ambientit Hapësinor në RK.


Vërejtje: Me rastin e ofertimit OE duhet të prezantoj edhe katalog/broshurë ose listë me të gjitha preparatet, të cilat Kompania posedon dhe i përdorë për kryerjen e shërbimeve të DDD-së si dhe certifikatat përkatëse të preparateve. Të gjitha aktivitetet të zhvillohen konform standardeve të përcaktuara për shëndet dhe siguri në punë, duke shfrytëzuar preparate cilësore të destinuara për tregun e Evropës dhe të lejuara nga inspektorati Sanitar i Kosovës.

Shërbimet e Dezinsektimit dhe Dezinsektimit të kryhen dy herë në vit (Pos.1),

Deratizimi të kryhet vetëm një herë në vit (Pos.2) dhe atë në periudhën e vjeshtës.

Në raste të veçanta, vetëm në objektet policore dhe hapësirat e jashtme ku paraqitet nevoja, shërbimet e DDD-së dhe largimi i zvarranikëve mund të realizohen me kërkesa të veçanta nga autoriteti kontraktues sipas indikacioneve epidemiologjike.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES



B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzësit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore.

Nr. i Prokurimit:	214-22-5200-2-1-1
Nr i brendshëm	214/22/078/211

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave ² (€)
1	Grup i Operatorëve Ekonomik S.V.Veterina; & N.N.P. Wenda 65 rr.Qameris, VUSHTRRI	188,111.65 €
2	DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.	192,669.56 €
3	Grup i Operatorëve Ekonomik Samire Osmani; Besim A. Zejnullahu B.I.	214,938.19 €
4	Grup i Operatorëve Ekonomik VLERA SH.P.K.; EGIAN MED SH.P.K.	217,973.98 €
5	MONUNI SH.P.K.	229,199.47 €
6	FLOMED SH.P.K.	232,551.08 €
7	Grup i Operatorëve Ekonomik MBURROYA SH.P.K.; Vector Pest Control SH.P.K.	336,899.16 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Policia e Kosovës për këtë aktivitet të prokurimit, **shpërblen** me kontratë DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K në vlerë totale të ofertës prej **192,669.56 €**.

Data: 27/04/2023

Emri dhe mbiemri i ZPP: Almuja

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Ekspertit teknik ka kerkuar sqarime nga MMPHI si në vijim;

Kërkese për informate

Expires 6/10/2028

Autorizimi_ekspert_teknik_2023_0283 Fitim Sopjani.pdf
763 KB

Leje per import te produkteve biocide te modifikuara.pdf
186 KB

woodstream-di-t-s-snake-a-way-snake-repellent-granular-sds-100018101.pdf
1 MB

I nderruar.

Jam Fitim Sopjani – Ekspert Teknik në Organin Shqyrtues të Prokurimit – OSHP. Jemi të autorizuar që të shqyrtojmë ankesën Nr. 238-23 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbime të Dezinsektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në Objektet Policore” me nr.prokurimit 214-22-5200-2-1-1 të inicuar nga Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës.

Duke ju dëshiruar javë të mbarë pune, kërkojmë informacione lidhur me Leje për import të produkteve biocide të notifikuara:

Sipas vendimit Nr.22/2940/-1-ZSP dt. 15.06.2022, është lejuar importi i disa produkteve biocide të notifikuara për Operatorin Ekonomik “DoctorExterminator D.D.D” Sh.p.k. – Prishtinë sipas ligjit Nr.03/L-119, ndër produktet e autorizuar gjendet edhe Produkti me substancë aktive – *Sulfur* me pershkrim - *Snake – A – Way – Snake – repelling – Granules*, me sasi – **200 kg**, dhe numer notifikues – **1894/2940/22/KS**, lloji i produktit biocid (PT) – *Repelent*.

Ju lutem të na informoni sipas akteve ligjore dhe nënligjore aktuale në fuqi si dhe Direktivës Europiane për produkte biocide se ky produkt a mund të importohet dhe të përdoret në Republikën e Kosovës.

Me qenë se leja është e vlefshme per periudhen 1 vjecare nga data e lëshimit të saj, gjatë periudhës së vlefshërisë së lejes është ndryshuar ligji për produktet biacide me datë 19.08.2022 hynë në fuqi ligji Nr. 08/L-065, në këtë rast nëse me ligjin aktual do të kemi produkte të ndaluara edhe pse ka vlefshmëri vendimi aktual a do të duhet të ndalohen (revokohet apo të bëhet plotësim/ndryshimi i Leje për import të produkteve biocide të notifikuara) për kto preparate biocide apo si veprohet?

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj!
Mbesim me shpresë në një përgjigje të shpejt për shkak afatave në përfundim të lëndës.

Bashkëngjitur gjeni:

- > Leje për import të produkteve biocide të notifikuara për O.E. në fjalë.
- > Informacionet deturuese të produktit (Safety Data Sheet)
- > Autorizimi nga OSHP / Ref.2023/0283 dt. 05.06.2023.

Me respekt
Fitim Sopjani
Ekspert Teknik - OSHP

Sent from Mail for Windows

Nazmi Maxhera | fitimsopjani@gmail.com; Majlinda Bedrolli; OSHP; Izedin Bytyqi; Ismail Hetemaji; Florent Ramqaj; Esidora Ismajli; Lendita Sopa

Përgjigje

Retention Policy DelFiveYOldEm (5 years)

Expires 6/11/2028

20230613082535268.pdf
80 KB

20230613073336876.pdf
65 KB

20230613074304534.pdf
54 KB

Të nderruar : Ju njoftoi me përgjigjen për Z.Fitim Sopjani drejtuar MMPHI-is

Përgjigje

Bazuar në shkresën drejtuar MMPHI –is nga eksperti në Organin Shqyrtues të Prokurimit – OSHP Z.Fitim Sopjani ne lidhje me Leje për import të produkteve biocide , ku sipas vendimit Nr.22/2940/-1-ZSP dt. 15.06.2022 për Operatorin Ekonomik “Doctor Exterminator D.D.D” Sh.p.k. – Prishtinë sipas ligjit Nr.03/L-119, Produkti me substancë aktive – *Sulfur* me pershkrim - *Snake –A – Way –Snake – repelling – Granules*, me sasi – **200 kg**, dhe numer notifikues – **1894/2940/22/KS**, lloji i produktit biocid (PT) – *Repelent* është i lejuar pasi qe importi argumentohet me të dhanat e më poshtëme sipas dispozitivave të Regullores së Bashkis Evropiane 1451/07 ku janë paraqit substancat aktive të lejura për përdorim nga Agjensioni Evropian i Kimikateve (ECHA),në të cilën edhe ne bazohemi edhe pse sjemi antar të BE por monitorohemi dhe jemi si vezhgus në proceset e zhvillimit.

Vleshmëria e vendimit të lejes eshte per periudhen 1 vjecare nga data e lëshimit të saj, gjatë periudhës së vlefshërisë së lejes është ndryshuar ligji për produktet biacide me date 19.08.2022 hynë në fuqi ligji Nr. 08/L-065, ky vendim vlen deri me date 15.06.2023 .

Kjo vërtetohet me të dhënat të paraqitura si ne:

Regulloren e BE në faqen 325/3 dhe faqen 325/23 ku janë të dhënat e substancës aktive ne këtë rastë bëhet fjalë per **Sulfur** me **EC-231-722-6** dhe Cas. **7704-34-9** me të dhënat nga SDS (lista e sigurisë teknike) per produktin *Snake – A – Way –Snake – repelling – Granu*

Me respekt!

Nazmi Maxhera

Zyrtar për produktet biocide
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Officer for biocide products ;
Ministry of Environment and Spatial Planning
Department of Environmental
Adresa: Rruga Luan Haradinaj (ish Pallati i Mediave Rilindja)
Kati XV, 10000 Prishtinë, Kosovë
☎ +383 200 320 33 / 044-049 / 196 750;
✉ nazmi.maxhera@rks-gov.net

;

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **FLOMED SH.P.K.**

Autoriteti Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS** gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës shërbim. Vlera e parashikuar 379 614,27 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**.

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër letrës standarde për tenderuesin e pasuksesshëm të datës 27.04.2023 ku AK – **POLICIA E KOSOVËS**, ka potencuar: *“tenderi juaj nuk qe tenderi me çmimin më të ulët”* në mesin e tenderëve qe plotësojnë kërkesat e dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Kundër njoftimit B58 njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues OE ankues paraqet kërkesë për rishqyrtim. AK me datë 10.05.23 nëpërmjet vendimit refuzon kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime dukshëm më të ulëta se sa çmimet e tregut në vendin tonë dhe në rajon.

Eksperti shqyrtues teknik sqaron se AK para se të inicioj një aktivitet të prokurimit ka për obligim që të hulumtoj tregun dhe të siguroj informatat e nevojshme për produktet apo shërbimet të cilat i prokuron. Andaj është përgjegjësi dhe në diskrecion të autoritetit kontraktues sa i përket qimeve

barra bie mbi Autoritetin Kontraktues konform nenit 61 të LPP-së.

Pretendimet ankimore në tersi janë trajtuar nga **ekspertit teknik** dhe atë si më poshtë:

Pretendimet e O.E. ankuese për llojin e preparatit repeluese për gjarprinj të cilët janë të ndaluar nga OBSH dhe EU.

Autoriteti kontraktues :Policia e Kosovës” ka kërkuar në specifikimin teknik të detyrueshëm

aparartet dhe preparatet si në vijim:

Largimi i zvarranikëve – Për kryerjen e këtij shërbimi të përdoret njëri lloj i këtyre aparateve apo vetëm granulat.

1 - Aparate me vibrim për dëbimin e zvarranikëve me bateri që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 300 - 400 m² për largimin e Zvarranikeve, të qëndrueshëm ndaj lagështisë. ose

2 –Aparate solare me vibrim për dëbimin e zvarranikëve që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 600 – 700 m² për largimin e Zvarranikëve të qëndrueshëm ndaj lagështisë.

3 – Preparate repelente ekologjike si granula për largimin e zvarranikëve me efektivitet optimal.

Si ekspert teknik i autorizuar nga OSHP për lëndën në fjalë, kam kërkuar informacion nga Sekretariati i MMPHI-së lidhur me vendimin Ref. 22/290/1-284/DMMU ku kam kërkuar informacion si në vijim:

*Sipas vendimit Nr.22/2940/-1-ZSP dt. 15.06.2022, është lejuar importi i disa produkteve biocide të notifikuara për Operatorin Ekonomik “DoctorExterminator D.D.D” Sh.p.k. – Prishtinë sipas ligjit Nr.03/L-119, ndër produktet e autorizuar gjendet edhe Produkti me substancë aktive – **Sulfur** me pershkrim - **Snake – A – Way – Snake – repelling – Granules**, me sasi – **200 kg**, dhe numër notifikues – **1894/2940/22/KS**, lloji i produktit biocid (PT) – **Repelent**.*

Ju lutem të na informoni sipas akteve ligjore dhe nënligjore aktuale në fuqi si dhe Direktivës Europiane për produkte biocide se ky produkt a mund të importohet dhe të përdoret në Republikën e Kosovës.

Me qenë se leja është e vlefshme për periudhën 1 vjeçare nga data e lëshimit të saj, gjatë peridhës së vlefshërisë së lejes është ndryshuar ligji për produktet biacide me datë 19.08.2022 hynë në fuqi ligji Nr. 08/L-065, në këtë rast nëse me ligjin aktual do të kemi produkte të

ndaluar edhe pse ka vlefshmeri vendimi aktual a do të duhet te ndalohen (revokohet apo të bëhet plotësim/ndryshimi i Leje për import të produkteve biocide të notifikuara) për kto preparate biocide apo si veprohet?

Me datë 13.06.2023 kemi pranuar përgjigjen e mëposhtme:

Te nderuar : Ju njoftoi me pergjigjen për Z.Fitim Sopjani drejtuar MMPHI-is

Përgjigje

*Bazuar në shkresën drejtuar MMPHI –is nga eksperti në Organin Shqyrtues të Prokurimit – OSHP Z.Fitim Sopjani ne lidhje me Leje për import të produkteve biocide , ku sipas vendimit Nr.22/2940/-I-ZSP dt. 15.06.2022 për Operatorin Ekonomik “Doctor Exterminator D.D.D” Sh.p.k. – Prishtinë sipas ligjit Nr.03/L-119, Produkti me substancë aktive – **Sulfur** me përshkrim - **Snake – A – Way – Snake – repelling – Granules**, me sasi – **200 kg**, dhe numer notifikues – **1894/2940/22/KS**, lloji i produktit biocid (PT) – **Repelent** është i lejuar pasi qe importi argumentohet me të dhanat e më poshtëme sipas dispozitave te Rregullores së Bashksis Evropiane 1451/07 ku janë paraqit substancat aktive të lejura per përdorim nga Agjensioni Evropian i Kimikateve (ECHA),në të cilën edhe ne bazohemi edhe pse sjemi antar të BE por monitorohemi dhe jemi si vezhgus në proceset e zhvillimit.*

Vlefshmëria e vendimit të lejes është për periudhën 1 vjeçare nga data e lëshimit të saj, gjatë periudhës se vlefshmërisë së lejes është ndryshuar ligji për produktet biacide me datë 19.08.2022 hynë në fuqi ligji Nr. 08/L-065, ky vendim vlen deri me datë 15.06.2023 .

Kjo vërtetohet me të dhënat të paraqitur si ne:

*Rregulloren e BE në faqen 325/3 dhe faqen 325/23 ku janë te dhënat e substancës aktive ne këtë rast bëhet fjalë per **Sulfur me EC-231-722-6 dhe Cas. 7704-34-9** me të dhënat nga SDS (lista e siguris teknike) per produktinë **Snake – A – Way – Snake – repelling – Granu***

Pas verifikimeve te cilat kam bërë në aktet ligjore të cilat janë bazuar ne kthim të përgjigjes se dhe vendimeve te cilat i kanë lëshuar për leje të importit për produkteve biocide kam hasur se MMPHI/DMMU ka shfrytëzuar directive evropiane (1451/07) e cila është e shfuqizuar nga 29.10.2014, ku vërtetohet se substance active e cila kemi kërkuar informacion ka qene e lejuar gjate kësaj periudhe, mirëpo me hyrje në fuqi të Rregulloreë Nr. 528/2012/EU e Parlamentit Evropian dhe

Këshillit e datës 22 Maj 2012, si dhe të direktivës evropiane për produktet biocide të lejuara për përdorim (Direktiva Eurpoiane Nr. 1062/2014 dt. 04.08.2014 si dhe plotësim/ndryshimi i datës 19.06.2022, preparatet me substanca aktive Sulfur nuk janë të lejuara.

Kjo vërtetohet edhe bazuar në informatat nga Agjensioni European për Kemikate (ECHA)

Shih linkun e mëposhtëm.

<https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-active-substances>

Andaj, si përfundim mund të konstatojmë se qëndron e bazuar ankesa e O.E Flomed Sh.p.k lidhur me pretendimet se O.E Fitues ka ofertuar preparate të ndaluara për përdorim.

III Lidhur me Ankesën tek preparatet dezinfektuese

Nga A.K ne specifikimin teknik të detyrueshëm është cekur se preparati për dezinfektim duhet të jetë me përmbajtje aktive të dezinfektuesve si Didecyldyoctyl ammonium chloride 6.0gr ose të ngjashme me efekt baktericid, fungicid. sporocid dhe virucid.

Lejohet për përdorim edhe preparati ekuivalent me efekt të njëjtë.

Oferta e O.E Fitues nga A.K. përmbajt 3 lloje të dezinfektuesve si në vijim:

Actosal Flache AF

përmban substance aktive të kërkuar por të shprehur në përqindje e cila është brenda intervalit të kërkuar (kjo mund të vërtetohet bazuar në SAFETY DATA SHEET të produktit e cila gjendet në ofertën e tenderit nga subjekti “DoctorExterminator D.D.D”Sh.p.k. – Prishtinë. Për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “DoctorExterminator D.D.D”Sh.p.k. – Prishtinë.

Ultrazol Active

përmban substance aktive e cila nuk është e lejuar për përdorim, gjithashtu edhe për këtë preparat me substance aktive nuk ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “DoctorExterminator D.D.D”Sh.p.k. – Prishtinë.

CLEANISEPT

përmban substance active të kërkuar, kjo mund të vërtetohet bazuar në SAFETY DATA SHEET të produktit e cila gjendet në dosjen e tenderit si dhe është bërë verifikimi se a kemi të bëjmë me substance active të ndaluar.

Bazuar në faktet e cekuar me lart konstatojmë se qëndron pjesërisht e bazuar ankesa e O.E. ankues, për pretendimet lidhur me preparatet për dezinfektim.

Gjithashtu vlen të ceket se edhe oferta e O.E Ankues posedon preparate të ndaluara për përdorim

Deconex 50AF

përmban substance active e cila është e lejuar për përdorim, gjithashtu për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “Flomed”Sh.p.k. – Prishtinë

Deconex 50FF

përmban substance active e cila është e lejuar për përdorim, gjithashtu për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “Flomed”Sh.p.k. – Prishtinë

Terralin protect

Ky product përmban 2 substanca active e cila alkyl (c12-16) dimethylbenzyl ammonium chloride nuk është e lejuar për përdorim dhe phenoxyethanol e cila është substance active e lejuar për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “Flomed”Sh.p.k. – Prishtinë

IV Lidhur me Ankesën tek preparatet dezinfektuese Dezinsektuese

AK. ka kërkuar preparate si në vijim:

Dezinsektuesit duhet të kenë në përbërjen e tyre substanca aktive si:

Cypermethrin 92 g/l

Tetramethrin 23g/l

Piperoniyl butoxide 115g/l.

Lejohet për përdorim edhe preparati ekuivalent me efekt të njëjtë.

Oferta e O.E Fitues nga A.K. përmbajt 8 lloje të dezinsuesve si në vijim:

Maxforce IC RB2 – Karem – Imidacloprid 0.028%

përmban substance active e cila nuk është e lejuar për përdorim

Maxforce PLATIN RB2 – KAREM – Clothianidin 1.0%

përmban substance active e cila është e lejuar për përdorim, gjithashtu për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “DoctorExterminator D.D.D”Sh.p.k. – Prishtinë.

Maxforce Quantum Ant Bait – Karem – Imidacloprid 0.028%

përmban substance active e cila nuk është e lejuar për përdorim, për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “DoctorExterminator D.D.D”Sh.p.k. – Prishtinë.

K-Otherine SC25 DELTAMETHERIN 2.5%

përmban substance active e cila nuk është e lejuar për përdorim, për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “DoctorExterminator D.D.D”Sh.p.k. – Prishtinë.

Quick Bayt – Imidacloprid 10%, Z-9-Tricosene 0.2%

përmban substance active e cila nuk është e lejuar për përdorim, për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “DoctorExterminator D.D.D”Sh.p.k. – Prishtinë.

K-Obiol EC 25 DELTAMETHERIN 2.70%, Piperonyl Butoxid 23.90%

përmban 2 substanca active e cila DELTAMETHERIN 2.70% nuk është e lejuar për përdorim dhe Piperonyl Butoxid 23.90% e cila është substance active e lejuar mirëpo, për këtë preparat me substancën active të Piperonyl Butoxid 23.90% nuk ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “DoctorExterminator D.D.D”Sh.p.k. – Prishtinë.

Aqua K-Otherin EË20 - DELTAMETHERIN 2.00%.

përmban substance active e cila nuk është e lejuar për përdorim, për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit

“DoctorExterminator D.D.D”Sh.p.k. – Prishtinë.

Catchmaster Glue Boards – ngjitës special.Për produktet e tilla nuk kërkohet leje për përdorim.

Bazuar në faktet e cekuar me lart konstatojmë se qëndron pjesërisht e bazuar ankesa e O.E. ankues, për pretendimet lidhur me preparatet për dezinfektim.

Gjithashtu vlen të ceket se edhe oferta e O.E Ankues posedon preparate të ndaluara për përdorim:

Piperoniyl butoxide technical 30%

përmban substance active e cila është e lejuar për përdorim, gjithashtu për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “Flomed”Sh.p.k. – Prishtinë

Lambda-cyhalothrin 9.7%

përmban substance active e cila nuk është e lejuar për përdorim, për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “Flomed”Sh.p.k. – Prishtinë.

Fipronil 0.01%

përmban substance active e cila nuk është e lejuar për përdorim, për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “Flomed”Sh.p.k. – Prishtinë.

Imidoclaprid 10% Z-9-Tricosene 0.1.

përmban substance active e cila nuk është e lejuar për përdorim, për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “Flomed”Sh.p.k. – Prishtinë.

Bifenthrin sc 9.7

përmban substance active e cila nuk është e lejuar për përdorim, për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit

“Flomed”Sh.p.k. – Prishtinë.

Floval Ce

përmban substance active e cila është e lejuar për përdorim, gjithashtu për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “Flomed”Sh.p.k. – Prishtinë

Neo-Permin

përmban substance active e cila është e lejuar për përdorim, gjithashtu për këtë preparat me substance aktive ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “Flomed”Sh.p.k. – Prishtinë

V Preparatet për Deratizimi

Për deratizim të objekteve të përdoret preparati deratizues Rodenticid – Anticoagulant i gjeneratës së dytë.

Preparati deratizues të vendoset në stacione të etiketuara dhe të bllobuara.

Përbërja e preparateve është kjo:

Bromadiolone 0.005 %.

Brodifacoum 0.005%

Me qenë se specifikimi teknik i detyrueshëm kërkon preparatet e mesiperme, ku keto preparate sipas Direktivës Europiane Nr. 1062/2014 dt. 04.08.2014 si dhe plotësim/ndryshimi i datës 19.06.2022 nuk janë pjesë e listës së substancave deratizuese (Biocide).

Oferta e O.E Fitues nga A.K. përmbajt 5 lloje të deratizuesve si në vijim:

Ratimor FB 200G Duplex XK përmbajtja aktive Bromadiolone 0.005%

përmban substance active e cila nuk është e lejuar për përdorim,.

Ratimor Brodifacoum Wax Blocks përmbajtja aktive Brodifacoum 0.005%

përmban substance active e cila nuk është e lejuar për përdorim

Ratimor ËB permbajtja active Bromadialone 0.005%

përmban substance active e cila nuk është e lejuar për përdorim

Generation Mini Blocks permbajtja active DIFETHIALONE 0.0025%

përmban substance active të lejuar, kjo mund të vërtetohet bazuar në SAFETY DATA SHEET të produktit e cila gjendet në dosjen e tenderit si dhe është bërë verifikimi se a kemi të bëjmë me substance active të ndaluar, ka Leje për import të produkteve biocide në emër të subjektit “DoctorExterminator D.D.D”Sh.p.k. – Prishtinë.

Catchmaster Glue BOARDS ngjitës special

Janë shqyrtuar të gjitha ofertave për këtë pozicion të specifikimit teknik, rekomandojmë AK. të anulon në tersi këtë aktivitet prokurimi, të përmirësohet specifikim teknik për preparatet e kërkuara, që mos të kërkohen preparate të cilat janë të ndaluara (Bromadialone 0.005 % dhe Brodifacoum 0.005%.) dhe në kundërshtim me listën e substancave active sipas Ligjit Nr. 08/L-065 dt.19.08.2022 si dhe Rregullores Nr. 528/2012/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 22 Maj 2012, si dhe të direktives evropiane për produktet biocide të lejuara për përdorim (Direktiva Eurpoiane Nr. 1062/2014 dt. 04.08.2014 si dhe plotësim/ndryshimi i datës 19.06.2022

Gjithashtu edhe oferta e O.E Ankues posedon preparate të ndaluara për përdorim me subatancat active të ndaluara për përdorim.

VI. Sa i përket pretendimit për largimin nga Dosja e tenderit të “Specialist Epidemiolog”.

Në këtë pretendim mund të konstatoj se AK. me rastin e ndryshimit ka njoftuar të gjitha palët e interesit nëpërmjet platformes së e-prokurimit, mbetet nën juridiksionin dhe përgjegjësinë e A.K. lidhur me kërkesat të cilat mendon se janë apo nuk janë të nevojshme për zhvillimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Përfundim:

Sipas të gjeturave të mësipërme, eksperti teknik vlerëson se “Policia e Kosovës” aktivitetin e

prokurimit “**Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore**” nr.i prokurimit 214-22-5200-2-1-1 që të anulohet në tersi, të përmirësohet specifikimi teknik i detyrueshëm sipas Ligjit Nr. 08/L-065 dt. 19.08.2022 i cili është i bazuar në **Rregulloren Nr. 528/2012/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 22 Maj 2012**, si dhe të direktivës evropiane për produktet biocide të lejuara për përdorim (**Direktiva Eurpoiane Nr. 1062/2014 dt. 04.08.2014** si dhe plotësim/ndryshimi i datës **19.06.2022**).

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit “**Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore**” me nr.të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, për përmirësim dhe hartim të specifikimit teknik në bazë të ligjit, rregullores dhe direktivave të cilat u dhanë sqarime më lartë.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **FLOMED SH.P.K.**



Majlinda Bedrolli

Fitim Sopjani